



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE



**THIRRJE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM
NË PROGRAMIN E DOKTORATËS PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023,
NË INSTITUTIN E STUDIMEVE EVROPIANE,
UNIVERSITETI I TIRANËS**

Drejtoria e Institutit të Studimeve Evropiane në Universitetin e Tiranës, në mbledhjen e datës 10.05.2023 vendosi hapjen e Aplikimeve për Programin e Doktoratës në “Studime Evropiane” për vitin akademik 2022-2023.

KALENDARI I THIRRJES

Afati i aplikimit	26 maj – 9 qershor 2023
Afati i shqyrtimit të dosjeve	9-18 qershor 2023
Shpallja e listës paraprake të fituesve	19 qershor 2023
Ankimime	19-21 qershor 2023
Shqyrtimi i ankimimit nga Komisioni ad-hoc	21-27 qershor 2023
Shpallja e listës përfundimtare të fituesve	29 qershor 2023

Shënim: Çdo kandidat depoziton dosjen në sekretarinë e ISE-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE



Hapja e programeve bazohet në legjislacionin si vijon:

- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 “Për Përcaktimin e Kritereve për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” dhe të Standardeve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 75, datë 12.02.2018 “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”.
- VKM Nr. 777, datë 26.12.2018 “Për Kontrollin Antiplagjiaturë të Disertacioneve për Fitimin e Gradave Shkencore”, i ndryshuar.
- Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për Përcaktimin e Niveleve të Gjuhëve të Huaja dhe të Testeve Ndërkombëtare, për Pranimet në Programet e Studimit të Ciklit të Dytë dhe të Tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 16, datë 08.07.2019, “Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë me Regjistrin Themeltar të Studentëve, Regjistrin e Arritjeve Akademike dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave dhe Certifikatave”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 20, datë 20.09.2019 “Për Skemën dhe Zbatimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor”.
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe Adminsitrimin e Regjistrave Shtetërorë të Gradave Shkencore dhe Titujve Akademikë të Lëshuar në Republikën e Shqipërisë”.
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE**



Arsimit të Lartë, Degëve të tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si dhe Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 7, date 31.03.2021.

- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.10, datë 30.03.2020 “Për Përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”.
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr 29, datë 10.09.2018 “Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në IAL”.
- Statuti i Universitetit të Tiranës.
- Rregullore “Për organizimin e programve të Studimit të Doktoratës në Universitetin e Tiranës”, miratuar me Vendimin Nr. 08 datë 26.04.2021.
- Urdhër i Ministrit të Arsimit Nr. 154, datë 24.03.2022 “Për Riorganizimin e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë në “Studime Evropiane” në Universitetin e Tiranës”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE



Program i Studimit të Ciklit të Tretë

Doktoratë në “Studime Evropiane”

Programi i doktoratës në “Studime Evropiane” synon të nxisë kërkimin shkencor duke u orientuar drejt thellimit, rikonceptimit dhe riintegritimit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor në fushë. Studimet e doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës (disertacionit), të nevojshme për marrjen e gradës shkencore “Doktor” dhe lidhen me projektet kërkimore të fushës.

Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushën dhe nënfushat e përcaktuara nga ISE, sipas objektivave të shpallura, me prioritet për thellimin e kërkimit shkencor.

Puna kërkimore si mjet për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm të ISE-së, në funksion të zhvillimit të prioriteteve kërkimore, në përputhje me misionin dhe strategjinë e kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës;

Përmes këtij program studimi, ISE ofron mundësi dhe hapësirë për stafin akademik në punën kërkimore, aktivitetin akademik të tyre si dhe për vlerësimin e performancës dhe progresin e bërë në këtë drejtim. Kjo merr rëndësi në kushtet e konkurrencës dhe për t’iu përgjigjur sfidave për një institucione që ofrojnë arsim dhe kërkim sa më cilësor dhe në shërbim të interesave të vendit dhe shoqërisë.

Në shoqërinë e sotme të bazuar në dije, del si domosdoshëri edhe pozicionimi më aktiv i ISE-së, duke kaluar dhe synuar një rol gjithnjë e më aktiv, të orientuar nga tregu dhe nevojat e tij, duke iu përgjigjur më mirë nevojave të shoqërisë dhe prioriteteve të vendit.

Një pjesëmarrje rritje e partneriteve dhe bashkëpunimit mes aktorë të tjerë për aktivitete, studime, apo forma të tjera bashkëpunimi me interes, si dhe pjesëmarrje më e madhe për t’u angazhuar në kërkime bashkëpunuese ndërkombëtare;

Për shkak të mundësive të shumta që ka sot, ISE mund dhe duhet të përfitojë më shumë nga projekte të përbashkëta me aktorë të ndryshëm publikë dhe/ose jopublikë, si dhe nga fonde të dedikuara për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin, në përputhje me prioritetet akademike e zhvillimore në rang institucional, por me vlerë dhe impact edhe për institucionet shqiptare dhe shoqërinë në tërësi;

ISE synon të shërbejë edhe si *think tank* apo si qendër ekselence dhe ekspertize në çështje që lidhen me studimet evropiane dhe procesin e integritimit evropian.



✓ **Nënfusha: “LEGJISLACION DHE INSTITUCIONE”**

➤ **Drejtimi kërkimor**

Proceset transformuese të qeverisjes vendore në Shqipëri në përgatitje për integrimin evropian – rasti i fondeve strukturore dhe të kohezionit

Objektivat

1. Një studim i thelluar i qeverisjes vendore në Shqipëri në perspektivë historike për të evidentuar vecoritë e zhvillimit territorial, tipologjinë e administratës publike, proceset demokratike të perfaqesimit dhe mirëqeverisjes
2. Analizë e zbatimit të politikës së BE për zhvillimin rajonal dhe kohezionin me fokus partneritetin e aktorëve në territor dhe rolin e qeverisë vendore
3. Përfaqje krahasuese mes tipologjise së qeverisjes vendore dhe kushteve për t’u plotësuar në kuadër të përthithjes së fondeve strukturore për kohezionin
4. Propozime për përgatitjen e zbatimi i politikave të kohezionit si proces transformues i qeverisjes vendore në Shqipëri me bazë partneritetin e aktorëve në territory.

✓ **Nënfusha: “Edukimi dhe komunikimi në arsimin shqiptar”**

➤ **Drejtimi kërkimor**

Nga pedagogjia socialiste e “shkollës së re” te pedagogjitë e reja

Objektivat

1. Boshti ideologjik-politik i “pedagogjisë së re” socialiste: një model komunikimi hierarkik dhe autoritar;
2. Mes pedagogjisë së traditës dhe pedagogjisë socialiste;
3. Edukimi komunist: një koncept i zgjeruar i edukimit në pedagogjinë socialiste;
4. Sfidat e shkollës shqiptare në një sistem të ri, hapësira kulturore e ndërhyrjes – dimensionet kulturore;
5. Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës: procesi i desovjetizimit dhe revolucionarizimi i metodave;
6. Shtypja – Ndërgjegjësimi – Çlirimi: mendimi pedagogjik i Paulo Freire
7. Edukimi dhe Komunikimi: historia e një takimi dhe udhëpërshkrime të reja



Pranimet në Ciklin e Tretë të Studimeve

Doktoratë në “Studime Evropiane”

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e Doktoratës

- Të ketë fituar diplomën ‘Master i shkencave’ ose “Master i Arteve”, apo diplomë të barasvlershme të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente, në fushë të njëjtë ose të përafërt me studimet e doktoratës, si: ekonomik, drejtësi, shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, shkenca sociale, studime gjuhësore, shkenca edukimi, gjuhë e huaj, shkenca komunikimi;
- Të ketë njohje të gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht) në nivelin C1, vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- Të ketë notë mesatare të përgjithshme në nivelin më të lartë të studimeve 8 e lart, e llogaritur në bazë të grup-lëndëve profesionale të programit të studimit;
- Të marrë përsipër përmbushjen e standardeve shkencore, akademike, ligjore dhe etike.



Dokumentacioni i aplikimit

Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës në ISE bën një kërkesë, e cila përfshihet në dosjen personale, që dorëzohet në njësinë bazë dhe përmban dokumentet e mëposhtme:

- a) Curriculum Vitae;
- b) kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë “Master ekzekutiv“, diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
- c) certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/ pasaportës;
- ç) dy rekomandime nga personeli akademik me titull “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”;
- d) dëshmi të gjuhës së huaj, sipas përcaktimeve ligjore;
- dh) dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore;
- e) deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
- ë) deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
- f) vendimi i njësisë bazë për fushat e kërkimit shkencor të njësisë;
- g) vendimi i njësisë bazë për pranimin e dokumentacionit për aplikim;
- gj) propozimi i kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe rrisitë, që pritet të sjellë punimi, plani i punës kërkimore shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
- h) vërtetim nga qendra e punës, që vërteton se kandidati ka angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë, apo është personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
- i) mandat pagese për tarifën e aplikimit;
- j) vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE



Mosplotësimi i njërit prej kritereve të mësipërme përbën shkak për moskualifikimin e kandidatit në fazën e vlerësimit të aplikimeve. Në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, do të ketë preferencë në përzgjedhje kandidatë që janë kanë përvojë si personel akademik në UT.

Nr. i kuotave për këtë program studimi në ISE për këtë vit akademik është dy (2), sipas miratimit nga MAS për këtë qëllim.

Personeli akademik

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës		Institucioni
		(Prof./Prof.As.)	Fusha	
1.	Aljula Jubani	Prof. Dr.	Shkenca gjuhësore dhe edukimi	ISE, UT
2.	Endira Bushati	Prof. As. Dr.	Legjislacion	ISE, UT